

**20050380588**

**L I G J I**  
**PËR NGARKIMIN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË ME HUA TE BANKA**  
**NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM - BANKA BOTËRORE**  
**SIPAS MARRËVESHJES PËR HUA PËR PROJEKTIN PËR KADASTRËN DHE**  
**REGJISTRIMIN E PATUNDSHMËRIVE**

Neni 1

Republika e Maqedonisë ngarkohet me hua te Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim - Banka Botërore, në shumë prej 10.300.000 euro, të dedikuara për realizimin e Projektit për kadastrën dhe regjistrimin e patundshmërive.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas nga neni 1 i këtij ligji, përcaktohen me Marrëveshjen për hua sipas Projektit për kadastrën dhe regjistrimin e patundshmërive, e cila do të lidhet ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim - Banka Botërore.

Në emër të Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjen për hua nga paragrafi 1 i këtij neni, do ta nënshkruajë ministri i Financave ose personi i autorizuar nga ai.

Neni 3

Afati për pagimin përfundimtar të huas nga neni 1 i këtij ligji është 17 vjet, me grejs periudhë 5 vjeçare të përfshirë dhe shkallë të kamatës prej LIBOR+0.75% në vit.

Huaja do të paguhet në 24 anuitete gjysmëvjetore, prej të cilave, duke filluar prej 15 nëntorit të vitit 2010 deri më 15 nëntor të vitit 2021, do të paguhet 23 anuitete gjysmëvjetore të njëjta, në shumë prej 430.000 euro dhe më 15 maj të vitit 2022, do të paguhet përfundimisht anuiteti i fundit në shumë prej 410.000 euro.

Në grejs periudhën prej 5 vjetësh, që përfaqëson edhe periudhë të realizimit të projektit, do të paguhet vetëm kamata e huas.

Neni 4

Më datën ose menjëherë pas datës së hyrjes në fuqi të Marrëveshjes për hua nga neni 2, paragrafi 1 i këtij ligji, paguhet provizion i njëhershëm - shpenzim në shumë prej 1% nga shuma e huas. Shuma e provizionit të njëhershëm mund të jetë edhe më e vogël se 1% në bazë të vendimit paraprakisht të marrë të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim -Bankës Botërore.

Për shumën e mjeteve të pa tërhequra të huas, paguhet provizion në lartësi prej 0,75% në vjet, të përcaktuar nga ana e Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim - Banka Botërore.

Provizioni nga paragrafi 2 i këtij neni, paguhet në gjysmë viti edhe atë më 15 maj dhe më 15 nëntor të çdo viti.

Neni 5

Shfrytëzues i mjeteve nga huaja për Projektin për kadastrën dhe regjistrimin e patundshmërive është Enti Shtetëror për Punë Gjeodezike.

Neni 6

Republika e Maqedonisë, huan nga neni 1 i këtij Ligji, do ta paguajë përfundimisht nga mjetet e parapara në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë për Entin Shtetëror për Punë Gjeodezike.

Neni 7

Në qoftë se Enti Shtetëror për Punë Gjeodezike nuk i servison në kohë obligimet e huas, ministri i Financave ka të drejtë të mos lejojë shfrytëzim të mjeteve të parapara në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë për Entin Shtetëror për Punë Gjeodezike të Republikës së Maqedonisë dhe ta bëjë ridestinimin e mjeteve të planifikuara buxhetore për vitin vijues deri në shumën, të cilën Republika e Maqedonisë në vitin vijues e ka borxh ndaj Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim - Banka Botërore, në bazë të kamatës dhe kryegjësë lëndë e Marrëveshjes për hua.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi me ditën e shpalljes në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.